



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

A.nr. 367/2022

në lidhje me ndryshimin e nenit 4 të Rregullores për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus

Drejtuar: Z. Ahmet Ismaili, Guvernator
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 14 prill 2025

Qëllimi i raportit

1. Ky raport ka për qëllim ta njoftojë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: BQK) për cenimin e së drejtës së pronës të të siguruarve, si pasojë e zbatimit jo të drejtë të nenit 4 [Rregulla tjera për bonusin dhe malusin], paragrafët 6, 7, 8, 9 dhe 10, të Rregullores për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus dhe adresimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit për evitimin e shkeljeve nga BQK-ja.

Baza ligjore

2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 1, përcakton: *“Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”*
3. Neni 135, paragrafi 3, përcakton: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
4. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *“Avokati i Popullit ka kompetencë për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, paragrafi 1);*
 - *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 2);*
 - *të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.”* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 5).
5. Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij në media, Avokati i Popullit synon t’i kryejë përgjegjësitë ligjore të lartpërmendura.

Përshkrimi i rastit

6. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka pranuar ankesë nga z. Isa Ilazi, parashtruar kundër BQK-së, lidhur me Rregulloren mbi Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus.
7. Në bazë të pohimeve të ankuesit vërehet se ai ka qenë i kategorizuar në shkallën e 4-t të sistemit bonus dhe me skadimin e regjistrimit të automjetit të tij, ai nuk e ka regjistruar automjetin për dy vjet, dhe kur ka vendosur ta regjistronte automjetin, ka

vizituar një nga pikat e kompanive të sigurimeve dhe nga zyrtarët përgjegjës është njoftuar se ai tani është kategorizuar në shkallën e 11-të, për shkak se nuk e ka regjistruar veturën për dy vjet. Më tej ankuesi ka njoftuar se ai nuk ka shkaktuar asnjë aksident, për të cilin shkak ndaj tij mund të shqiptohet “malusi”.

8. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit i ka dërguar shkresë Guvernatorit të BQK-së dhe ka kërkuar informata lidhur me çështjen në fjalë.
9. Guvernatori i BQK-së ka kthyer përgjigje dhe e ka njoftuar Avokatin e Popullit se veprimet e tilla janë të bazuara në nenin 4 [Rregulla tjera për bonusin dhe malusin], paragrafët 6, 7, 8 dhe 9, të Rregullores për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus. Më tej në përgjigje theksohet se qëllimi i Rregullores për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus është edukues dhe shpërblyes në vazhdimësi për policëmbajtësit, të cilët janë të kujdesshëm në zbatimin e rregullave për sigurimin e automjetit.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

10. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 46, paragrafi 1, përcakton: “*E drejta e pronës është e garantuar.*”

11. Ligji nr. 05/L-132 për Automjete:

Neni 39 [Kushtet për pjesëmarrje në trafik rrugor], paragrafi 1, përcakton: “*Në mënyrë që të marrin pjesë në trafik rrugor, mjetet duhet të jenë të regjistruara [...].*”

12. Ligji nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor:

- Neni 247 [Largimi i mjetit të paregjistruar nga trafiku], paragrafi 1, përcakton: “*1. Polici do të largojë nga trafiku mjetin që nuk është regjistruar.*”
- Neni 247, paragrafi 2, përcakton: “*Shoferi i mjetit nga paragrafi 1. i këtij neni, i cili haset në trafik me mjetin e pa regjistruar, regjistrimi i të cilit ka skaduar për jo më gjatë se tridhjetë (30) ditë, dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) eurosh, mjetit do t’i konfiskohen targat e regjistrimit deri në regjistrimin apo ç lajmërimin e tij.*”

13. Ligji nr. 03/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia:

- Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.10, përcakton: “*Rast i siguruar - ngjarja e cila kur të ndodhë, rezulton me të drejtën për kompensim për dëmin e shkaktuar nga mjeti motorik.*”
- Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11, përcakton: “*I siguruari - personi, interesi pasuror i të cilit është siguruar në rast përgjegjësie nga posedimi dhe përdorimi i mjetit motorik.*”
- Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.22, përcakton: “*Sigurimi i autopërgjegjësisë - sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë së pronarit dhe poseduesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve te treta.*”
- Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.23, përcakton: “*Polica e sigurimit – kontrata e sigurimit të autopërgjegjësisë, respektivisht certifikata e standardizuar e sigurimit*

të firmosur nga siguruesi dhe i siguruari me të cilën provohet kontraktimi i sigurimit të autopërgjegjesisë.”

- Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.24, përcakton: *“Sistemi Bonus-Malus – është sistemi i cili zbatohet si korrektues i lartësisë së primit të sigurimit të autopërgjegjesisë, bazuar në historikun e dëmeve të të siguruarit.”*
- Neni 3 [Subjekti i Sigurimit], paragrafi 1, përcakton: *“Pronari i mjetit motorik para përdorimit të tij duhet të kontrakttojë sigurim për mbulimin e përgjegjesisë për dëmet e shkaktuara palëve të treta në rast vdekje, lëndimeve trupore, dëmtimit të shëndetit apo dëmtimit në pasuri.”*
- Neni 7 [Detyrimi për kontraktimin e sigurimit], paragrafi 1, përcakton: *“Pronari i mjetit motorik detyrohet të lidhë kontratë të sigurimit [...]”*
- Neni 8 [Kushtet dhe primi i sigurimit të detyrueshëm], paragrafi 1, përcakton: *“BQK-ja ka kompetencë të nxjerrë rregulla që përcaktojnë strukturën e primit që siguruesi duhet të zbatojë në caktimin e primit për sigurimin. Rregullat mund të përcaktojnë strukturën e saktë të primit, shumën minimale apo maksimale apo një kufi brenda të cilit primi duhet të jetë.”*

14. Rregullorja për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus:

- Neni 2 [Përkufizimet], paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, përcakton: *“Sistemi Bonus-Malus - është sistemi i cili zbatohet si korrektues i lartësisë së primit të sigurimit të autopërgjegjesisë, bazuar në historikun e dëmeve të të siguruarit (policëmbajtësit).”*
- Neni 3 [Bonusi dhe malusi], paragrafi 1, përcakton: *“Secilit të siguruar në Kosovë, që ka kontratën (policën) e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia me afat të paktën një vit, niveli i primit i caktohet sipas shkallëve të sistemit bonus-malus, varësisht nga fakti nëse në periudhën e kaluar të sigurimit (vëzhgimit) ka pasur dëme të deklaruara apo jo.”*
- Neni 3, paragrafi 7, përcakton: *“Nëse i siguruari ka qenë i siguruar të paktën një vit dhe nëse në periudhën e vëzhgimit nuk ka pasur dëme të deklaruara, të siguruarit për vitin pasardhës i aplikohet primi për një shkallë më të ulët, por jo më shumë se deri në shkallën e parë (1) të përcaktuar me paragrafin 9 të këtij neni.”*
- Neni 4 [Rregulla tjera për bonusin dhe malusin], paragrafi 6, përcakton: *“Nëse kontrata e sigurimit ka skaduar dhe i siguruari nuk kontraktton policë të re njëvjeçare brenda 15 ditëve nga data e skadimit, atëherë ndaj të siguruarit aplikohet shkalla e njëjtë e primit sikur të kontrata e fundit e skaduar, me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk është deklaruar dëm.”*
- Neni 4, paragrafi 7, përcakton: *“Nëse kontrata e sigurimit ka skaduar dhe i siguruari nuk kontraktton policë të re njëvjeçare, pas kalimit të periudhës kohore më shumë se 15 ditë dhe më pak se 45 ditë, nga data e skadimit, atëherë ndaj të siguruarit aplikohet një shkallë më e lartë e primit, por jo më shumë se shkalla 11,*

krahasuar me shkallën e primit të aplikuar në kontratën e fundit të skaduar, me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk është deklaruar dëm.”

- Neni 4, paragrafi 8, përcakton: “Nëse kontrata e sigurimit ka skaduar dhe i siguruari nuk kontraktonte policë të re njëvjeçare edhe pas kalimit të periudhës prej një 45 ditëve deri në një vit nga data e skadimit, atëherë ndaj të sigurvearit aplikohet primi dy shkallë më i lartë, por jo më shumë se shkalla bazë e primit (shkalla 11), krahasuar me shkallën e primit të aplikuar në kontratën e fundit të skaduar, me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk është deklaruar dëm.”
- Neni 4, paragrafi 9, përcakton: “Nëse kontrata e sigurimit ka skaduar dhe i siguruari nuk kontraktonte policë të re njëvjeçare edhe pas kalimit të periudhës prej një 45 ditëve deri në një vit nga data e skadimit, atëherë ndaj të sigurvearit aplikohet primi dy shkallë më i lartë, por jo më shumë se shkalla bazë e primit (shkalla 11), krahasuar me shkallën e primit të aplikuar në kontratën e fundit të skaduar, me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk është deklaruar dëm.”
- Neni 4, paragrafi 10, përcakton: “Në rastet kur i siguruari ka qenë i kategorizuar në një shkallë të malusit dhe nuk kontraktonte policë të re njëvjeçare brenda periudhës trevjeçare nga data e skadimit të policës së fundit, atëherë i siguruari rikthehet në shkallën bazë të primit (shkalla 11), me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk ka dëm të raportuar. E njëjta procedurë aplikohet edhe në rastet kur siguresi ka bazë ligjore për të refuzuar dëmin, pas raportimit të dëmit.”

Analiza ligjore

15. Në bazë të rrethanave të theksuara më sipër, Avokati i Popullit ka vërejtur se Republika e Kosovës ka miratuar kornizë të mjaftueshme normative, përmes së cilës rregullohen çështjet e automjeteve dhe regjistrimit të tyre.
16. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se sipas Ligjit për Automjete, mjetet duhet të jenë të regjistruara, në mënyrë që të kenë të drejtë të dalin në trafik. Për më tepër, Avokati i Popullit thekson se sipas Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, shoferi i cili haset në trafik me mjet të paregjistruar, dënohet për kundërvajtje dhe polici do ta largojë nga trafiku mjetin e paregjistruar.
17. Sipas këtij përcaktimi, Avokati i Popullit konsideron se është kompetencë e policisë që ta kontrollojë daljen në trafik të mjeteve të paregjistruara dhe të shqiptojë gjoba kundërvajtëse ndaj pronarëve të mjeteve të paregjistruara të cilat hasen në trafik.
18. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka vërejtur se siguri i automjeteve është detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 03/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia), i cili ka për qëllim sigurimin e mbulimit të dëmeve që shkaktohen në rast të aksidenteve. Sipas këtij përcaktimi, secili person që është pronar i automjetit detyrohet të lidhë kontratë të sigurimit [...] (neni 7, paragrafi 1).
19. Më tej Avokati i Popullit ka vërejtur se sipas këtij ligji: “Pronari i mjetit motorik para përdorimit të tij duhet të kontrakttojë siguri për mbulimin e përgjegjësisë për dëmet e

shkaktuara palëve të treta në rast vdekje, lëndimeve trupore, dëmtimit të shëndetit apo dëmtimit në pasuri” (neni 3, paragrafi 1). Sipas këtij përcaktimi, Avokati i Popullit konsideron se sigurimi i automjetit duhet të bëhet para se mjeti të dalë në trafik.

20. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit konsideron se sipas përcaktimeve të këtij ligji: *“BQK-ja ka kompetencë të nxjerrë rregulla që përcaktojnë strukturën e primit që siguruesi duhet të zbatojë në caktimin e primit për sigurimin [...] (neni 8, paragrafi 1). Po ashtu: “Në përlllogaritjen e primit të sigurimit të autopërgjegjësise duhet inkorporuar sistemin bonus-malus.” (neni 8, paragrafi 3).*
21. Avokati i Popullit ka analizuar Rregulloren për Zbatimin e Sistemit Bonus – Malus dhe ka vërejtur: *“Kjo rregullore përcakton mënyrën e zbatimit dhe përlllogaritjes së primit duke përfshirë sistemin bonus-malus ashtu siç është e përcaktuar në nenin 8, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.” (neni 1, paragrafi 1).*
22. Më tej Avokati i Popullit ka vërejtur: *“Secilit të siguruar në Kosovë, që ka kontratën (policën) e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia me afat të paktën një vit, niveli i primit i caktohet sipas shkallëve të sistemit bonus-malus, varësisht nga fakti nëse në periudhën e kaluar të sigurimit (vëzhgimit) ka pasur dëme të deklaruara apo jo.”*
23. Avokati i Popullit ka analizuar nenin 4 të Rregullores për Zbatimin e Sistemit Bonus - Malus dhe ka vërejtur se paragrafët 6, 7, 8, 9 dhe 10 përcaktojnë rrethanat të cilat merren parasysh nëse të siguruarit nuk lidhin menjëherë kontratë të re të sigurimit dhe efektit që krijohet në shkallët e bonusit.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

24. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, konstaton se në Republikën e Kosovës ekziston një sistem i rregullave që i rregullojnë çështjet e automjeteve, rregullave të trafikut rrugor dhe sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia.
25. Sipas këtyre rregullave, regjistrimi i automjeteve është detyrim ligjor, në mënyrë që mjetet të kenë të drejtë të dalin për qarkullim në trafik. Avokati i Popullit konsideron se është përgjegjësi e Policisë së Kosovës të mbikëqyrë qarkullimin e mjeteve në trafik dhe të veprojë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Rregullat e Trafikut rrugor, në raste kur hasen mjete të paregjistruara në trafik.
26. Më tej Avokati i Popullit konsideron se sipas përcaktimeve ligjore, pronarët janë të detyruar të bëjnë sigurimin e automjeteve para se ato të regjistrohen.
27. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit thekson se Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ka krijuar bazën ligjore, sipas së cilës, pronarët obligohen t’i sigurojnë mjetet e tyre para se ato të regjistrohen.
28. Avokati i Popullit ka vërejtur se sipas Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, sistemi bonus-malus zbatohet si korrektues i lartësisë së primit të sigurimit, duke u bazuar në historikun e dëmeve të shkaktuara nga i siguruari.

29. Më tej Avokati i Popullit ka vërejtur se sipas përcaktimeve të këtij ligji është autorizuar BQK-ja të nxjerrë rregulla që e përcaktojnë strukturën e primit që siguruesi duhet ta zbatojë në caktimin e primit për sigurimin.
30. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ka vërejtur se BQK-ja ka miratuar Rregulloren për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus. Sipas kësaj rregulloreje, Sistemi Bonus-Malus është sistemi i cili zbatohet si korrektues i lartësisë së primit të sigurimit të autopërgjegjësisë, bazuar në historikun e dëmeve të të siguruarit (policëmbajtësit) (neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1).
31. Po ashtu, Avokati i Popullit ka vërejtur se rregullorja ka përcaktuar se nëse i siguruari ka qenë i siguruar të paktën një vit dhe nëse në periudhën e vëzhgimit nuk ka pasur dëme të deklaruara, të siguruarit për vitin pasardhës i aplikohet primi për një shkallë më të ulët, por jo më shumë se deri në shkallën e parë [...] (neni 3, paragrafi 7).
32. Sipas këtyre përcaktimeve, Avokati i Popullit vlerëson se Rregullorja deri këtu e ka bartur frymën normuese sipas përcaktimeve dhe autorizimeve të dhëna në dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, sepse në të dyja rastet çmimi i sigurimit varet nga historiku i dëmeve të të siguruarit.
33. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh përcaktimet e rregullores në nenin 4, paragrafët 6, 7, 8, 9 dhe 10, ka vërejtur se pronarëve të mjeteve të cilët gjatë vitit të sigurimit nuk kanë shkaktuar asnjë dëm, mirëpo në vitin pasues nuk i regjistrojnë veturat sipas kohës së përcaktuar në nenin 4, paragrafët 6, 7, 8, 9 dhe 10, përveçqë nuk u zbatohet sistemi i bonusit (uljes së pagesës së sigurimit), ndaj tyre shqiptohet malusi (ngritja e çmimit të sigurimit).
34. Në këtë rast Avokati i Popullit ka vërejtur se rregullorja në përcaktimet e nenit 4, paragrafët 6, 7, 8, 9 dhe 10, nuk e ka bartur frymën e dispozitave të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.
35. Avokati i Popullit thekson se dispozitat e Rregullores për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus nuk janë në harmoni të plotë me njëra-tjetrën. Avokati i Popullit thekson se neni 4, paragrafët 6, 7, 8, 9 dhe 10, nuk janë në përputhje me nenin 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe me nenin 3, paragrafi 7, të Rregullores.
36. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh përcaktimet e mësipërme, konsideron se Rregullorja nuk e ka bartur frymën e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe si rezultat i kësaj e ka cenuar pronën e pronarëve të mjeteve, të cilat nuk regjistrohen sipas afateve të paragrafëve 6, 7, 8, 9 dhe 10, të nenit 4.
37. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit vë theksin te qëndrimet në Opinionin e Komisionit të Venecias për Kosovën, nr. 958/2019, të datës 14 tetor 2019, lidhur me Projektligjin për Aktet Normative, sipas të cilit: *“Zbatimi i ligjeve është detyrë e pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor. Pushteti ekzekutiv për të miratuar akte normative, është i kufizuar në delegimet që rrjedhin nga pushteti legjislativ, përkatësisht nga përcaktimet ligjore. Megjithatë, veprimet pa përcaktime ligjore do të ishin në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë dhe parimin e ndarjes së pushteteve.”* (Opinionin

i Komisionit të Venecias lidhur me Projektligjin për Aktet Normative, nr. 958/2019, të datës 14 tetor 2019, paragrafët 15 dhe 17).

38. Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit konsideron se nxjerrja e një akti nënligjor duke mos pasur një delegim të përcaktuar qartë nga ligji, rezulton me shkeljen e parimit të ligjshmërisë dhe parimit të ndarjes së pushteteve.
39. Për sa i përket rastit në fjalë, miratimi i Rregullores për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus, me përmbajtjen e nenit 4, paragrafët 6, 7, 8, 9 dhe 10, e ka tejkaluar kufirin e deleguar me dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe, si rezultat i kësaj, ka rezultuar me detyrimin e pronarëve që të paguajnë shumë më të madhe të çmimit për sigurimin e veturave të tyre, në vend se të paguanin shumën më të vogël, sipas historikut të dëmeve.
40. Në këtë rast Avokati i Popullit ka vërejtur se kjo dukuri është praktikuar edhe ndaj pronarëve të cilët kanë në pronësi dy apo më tepër mjete dhe kur vetëm njëri nga mjetet e tyre nuk është regjistruar brenda afateve të nenit 4, paragrafëve 6, 7, 8, 9 dhe 10, ndëshkimet janë shqiptuar ndaj të gjitha mjeteve të atij pronari.
41. Avokati i Popullit konstaton se detyrimi i pronarëve që të paguajnë më shumë për sigurimin e mjeteve të tyre ka rezultuar me shkeljen e së drejtës së pronës së pronarëve të mjeteve.
42. Në këtë drejtim, neni 46, par. 1, i Kushtetutës përcakton: “*E drejta e pronës është e garantuar.*” Po ashtu, neni 1 i Protokollit të Parë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) përcakton: “*Askush nuk mund të privohet nga posedimet e tij, përveçse [...] në kushtet e parashikuara nga ligji*” (theks i shtuar). E drejta e përcaktuar me këtë dispozitë, njësoj si të gjitha të drejtat e përcaktuara në KEDNJ dhe në Protokollin e saj, “*garantohet me këtë Kushtetutë*” (Kushtetuta, neni 22). Në të njëjtën mënyrë, neni 55, par. 1, i Kushtetutës përcakton: “*Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*” (theks i shtuar).
43. Për interpretimin e këtyre dispozitave duhet marrë parasysh neni 53 i Kushtetutës, i cili udhëzon: “*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*” (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNJ).
44. Kufizimi i së drejtës së pronës duhet të jetë i autorizuar me ligj dhe për ta argumentuar këtë do të bazohemi në vendimet gjyqësore të GjEDNJ-së. Sipas vendimeve gjyqësore të GjEDNJ-së, koncepteve të “pronës” dhe të “posedimit” u është dhënë një kuptim i gjerë, duke përfshirë çdolloj pronësie të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe një sërë interesash ekonomike. Në veçanti, GjEDNJ-ja ka konstatuar: “*Tatimi është, parimisht, një kufizim i së drejtës së garantuar me paragrafin e parë të nenit 1 të Protokollit të Parë [të KEDNJ-së], për shkak se ai [tatimi] e privon personin në fjalë nga një posedim, d.m.th., nga sasia e parave që duhet paguar*” (Burden v. United Kingdom, Aplikimi Nr. 13378/05, GjEDNJ, 29 prill 2008, § 59, (theks i shtuar). Sipas këtij arsyetimi, çdoherë kur shteti e detyron një individ të paguajë një sasi parash, kjo

konsiderohet një kufizim i së drejtës së pronës. Por ky kufizim është i bazuar në ligj, prandaj nuk përbën shkelje, për dallim nga rasti kur kufizimi i kësaj të drejte bëhet me çfarëdo akti tjetër që nuk e ka fuqinë e ligjit, e në rastin konkret është bazuar në Rregulloren BQK-së, e cila nuk është në pajtim me ligjin.

45. Rrjedhimit, Avokati i Popullit konsideron se obligimet e pronarëve për të paguar ngarkesën financiare e cila është përcaktuar në nenin 4, paragrafët 6, 7, 8, 9 dhe 10, të Rregullores, përbën kufizim të së drejtës së pronës, për shkak se pronarët nuk kanë hyrë në historikun e dëmeve dhe rrjedhimisht nuk duhet të kenë ngarkesa financiare në pagesën e sigurimit, pavarësisht kohës së regjistrimit të automjetit.
46. Prandaj Avokati i Popullit konstaton se sistemi *bonus-malus* duhet të implementohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe sipas neneve 2 dhe 3 të Rregullores për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus.
47. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh përgjigjen e Guvernatorit të BQK-së drejtuar Avokatit të Popullit, i cili ka theksuar se qëllimi i Rregullores për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus është edukues dhe shpërblyes në vazhdimësi për policëmbajtësit të cilët janë të kujdesshëm në zbatimin e rregullave për sigurimin e automjetit, konstaton se BQK-ja mund të miratojë rregulla të karakterit edukativ, mirëpo assesit nuk ka të drejtë të miratojë rregulla kushtëzuese, të cilat nuk bartin frymën e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe të cilat prodhojnë ngarkesë financiare për pronarët e mjeteve. Këtë konstatim Avokati i Popullit e bazon në faktin se vetëm Policia e Kosovës ka kompetenca ekskluzive për kontrollimin dhe ndëshkimin e pronarëve nëse dalin në trafik me mjete të paregjistruara.
48. Përfundimisht, Avokati i Popullit konsideron se është e nevojshme që të ndryshohet Rregullorja për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus, përkatësisht neni 4, paragrafët 6, 7, 8, 9 dhe 10, të harmonizohen me frymën e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, përkatësisht çmimi i pagesës së sigurimit të bazohet vetëm në historikun e dëmeve të të siguruarit.
49. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, bazuar në nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i

REKOMANDON

Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës:

- *Të ndryshojë Rregulloren për Zbatimin e Sistemit Bonus-Malus, përkatësisht t'i fshijë paragrafët 6, 7, 8, 9 dhe 10, të nenit 4 të Rregullores.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...]”).

duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit

